

Nr. Ref. BD-232/1

Në bazë të neneve 12.4, 13.1, dhe 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe neneve 4 dhe 10.5 të Statutit të Bordit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën me 04 maj 2026 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **Z. Gent Nushi** emërohet Zëvendës Kryesues i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM


Në mbledhjen e jashtëzakonshme të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të mbajtur me 04 maj 2026, Bordi aprovoi sipas procedurave propozimin e Kryesuesit dhe emëroi Z. Gent Nushi Zëvendës Kryesues i Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Ky vendim aprovohet në bazë të neneve 12.4, 13.1, dhe 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe nenit 3 të Statutit të Bordit të AKP-së. Duke u bazuar në këto dispozita Bordi shqyrtoi çështjen dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 04 maj 2026



Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-232/2

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 10.5 të Statutit të Bordit, në bazë të Rregullores Nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të Punës në AKP-ë, Ligjin për Zyrarët Publik 08/L-197, Rregulloren (QRK) NR. 15/2023 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me 04 maj 2026 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Obligohet Menaxhmenti/Divizioni i Burimeve Njerëzore të bëj publikimin e konkursit publik të rekrutimit për pozitën Drejtor Ekzekutiv i AKP-së.
- II. Ky vendim do të hyjë në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin për çështjen e shpalljes së konkursit publik për rekrutimin për pozitën Drejtor Ekzekutiv (DE) i Agjencisë.

Ky vendim është marr duke u bazuar në faktin se pozita e DE-së është duke u mbajtur me ushtrues detyre për një kohë të gjatë dhe me qëllim të rekrutimit përmes konkursit publik të plotësohet kjo pozitë në mënyrë që mandati i Agjencisë të vazhdoj me pozitë të DE.

Andaj duke u bazuar në atë që u tha më lartë Bordi shqyrtoi çështjen dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi ankesa mund të paraqitet pranë organeve kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Prishtinë, më 04 maj 2026.

  
Hekuran Nikçi  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit